



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1712/24 Datë: 20/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Plotësohet/ndryshohet vendimi i KShC-së Ref.:1382/24, datë:12/07/2024, për validim të akreditimit ndërkombëtarë të Kolegjit Heimerer, ashtu që paragrafit I, programit *Infermieri BSc 180 ECTS* i ndryshohet kuota (*numri i studentëve*) nga 200 student, në *250 studentë për vit akademik*.
- II. Pjesa tjetër e vendimit Ref.:1382/24, datë:12/07/2024 për validim të akreditimit ndërkombëtarë mbetet në fuqi dhe e pa ndryshuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Heimerer ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për rritjen e kuotës (numrit të studentëve) për vit akademik ashtu siç është aprovuar nga agjencia e vlerësimit ndërkombëtarë përkatësisht rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit/akreditimit nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).

Meqenëse Kolegji Heimerer kërkesën e kishte bazuar në raportet e ekspertëve të jashtëm ndërkombëtarë nga agjencia e lartcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Faqe 1 nga 1